

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vlora Hyseni lihet në arrest shtëpie. Ish-shefja e SHISH mohon akuzat në GJKKO dhe kërkon ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë. Javën e ardhshme mblidhet Këshilli i Sigurisë
ADRESA	https://versus.al/live-updates/ndihmonte-agasin-dhe-grupet-inale-lihet-ne-arrest-shtepie-ish-s-i47081
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 12:35:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 12:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1276b6f175791abbb2558bdd1c08270929fb1790866384c4fa00e087ea16cedb
TEKSTI	28b250a2b540f6ff7d5964250e152508f160598dd355dce420e251a831e7baa4
PAMJA	4c834d63b5c1a60e55d4462e81f13357daa9b71dee67e849073c1e2286ef7bd1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ffaaffd3862ff2eee02100e491c09615b2b14781a84f88b2ebb8128a2c86e1d9b
E MËPARSHMJA	3f2d8fcd0b33212f493ca747bc32089d747abf1254eb84e512d2756cdc10a751
RRËNJA MERKLE	de40688aef74c129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ffaaffd3862ff2eee02100e491c09615b2b14781a84f88b2ebb8128a2c86e1d9b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Vlora Hyseni lihet në arrest shtëpie. Ish-shefja e SHISH mohon akuzat në GJKKO dhe kërkon ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë. Javën e ardhshme mbledhet Këshilli i Sigurisë](#)

24 Shtator 2026, 14:07

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 24 Shtator 2026, 14:07

Vlora Hyseni lihet në arrest shtëpie. Ish-shefja e SHISH mohon akuzat në GJKKO dhe kërkon ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë. Javën e ardhshme mbledhet Këshilli i Sigurisë

*Vlora Hyseni u paraqit sot në Gjykatën e Posaçme nën shoqërimin e disa efektivëve të policisë duke qenë se ndodhet nën arrest shtëpiak. Pavarësisht se shumë prisnin që më së paku ajo të ndihej në

Siklet nga detajet e zbuluara, Hyseni bëri krejt të kundërtën dhe shantazhoi gazetaren Klodiana Lala e cila e pyeti për Ergys Agasin. Bisedat e publikuara tregojnë edhe njëherë kompromentimin e thellë të ish-shefes së SHISH e cila ishte vënë totalisht në shërbim të Agasit dhe njerëzve të tij. *Ish-shefja e SHISH qëndroi 1 orë e 30 minuta në GJKKO dhe ka mohuar akuzat për nxjerrje të sekreteve tek Ergys Agasi. *Ajo ka kërkuar ekspertim të telefonit të saj jashtë Shqipërisë.*GJKKO në reagimin zyrtar ka konfirmuar masën "arrest në shtëpi" ndaj Hysenit ndërsa shprehet se vendimi nuk do të publikohet deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Javën e ardhshme pritet të mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

Versus

Shkruar nga Versus

Çfarë do të gjeni në brendësi

*Vlora Hyseni u paraqit sot në Gjykatën e Posaçme nën shoqërinë e disa efektivëve të policisë duke qenë se ndodhet nën arrest shtëpiak. Pavarësisht se shumë prisnin që më së paku ajo të ndihej në siklet nga detajet tronditëse të zbuluara, Hyseni bëri krejt të kundërtën dhe shantazhoi gazetaren Klodiana Lala e cila e pyeti për Ergys Agasin. *Bisedat e publikuara tregojnë edhe njëherë kompromentimin e thellë të ish-shefes së SHISH e cila ishte vënë totalisht në shërbim të Agasit dhe njerëzve të tij. *Ish-shefja e SHISH qëndroi 1 orë e 30 minuta në GJKKO dhe ka mohuar akuzat për nxjerrje të sekreteve tek Ergys Agasi. *Ajo ka kërkuar ekspertim të telefonit të saj jashtë Shqipërisë.*GJKKO në reagimin zyrtar ka konfirmuar masën "arrest në shtëpi" ndaj Hysenit ndërsa shprehet se vendimi nuk do të publikohet deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Javën e ardhshme pritet të mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare

11 Postime

2 MINUTA ME PARE

"SHISH ka dosje për të gjithë", alarmon ish-deputeti: Vlora Hyseni do t'i përdorë për të shantazhuar prokurorë, gjyqtarë e zyrtarë



Politikani Enkelejd Alibeaj ka ngritur shqetësimin për mënyrën se si mund të përdoren informacionet dhe dosjet që ish-drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni, mund të ketë pasur në dispozicion gjatë kohës që drejtonte institucionin.

Alibeaj tha se, sipas tij, sjellja e Hysenit mund të marrë formën e një qasjeje shantazhuese, duke pretenduar se në shënjestër mund të jenë prokurorë, gjyqtarë, institucione të drejtësisë dhe zyrtarë të lartë, përfshirë kryeministrin.

"Më e rënda është sjellja që ka mbajtur zonja. Është qasja për të bërë shantazh. E bëri sot dhe do ta bëjë edhe në të ardhmen", deklaroi Alibeaj.

Ai shtoi se Hyseni, sipas tij, nuk duhet parë si person i vetëm në këtë situatë, por si pjesë e një grupi më të gjerë njerëzish që mund të kenë interesa të përbashkëta./Versus.al

20 MINUTA ME PARE

Vlora Hyseni kërkoi ekspertizë të telefonit jashtë Shqipërisë, zbardhet dëshmia e ish-shefes së SHISH në GJKKO





Ish-shefja e SHISH, Vlora Hyseni, u mor sot në pyetje për 1 orë e 30 minuta, në kuadër të hetimeve të SPAK.

Hyseni ka mohuar akuzat e ngritura ndaj saj dhe ka kërkuar që telefoni i saj, i sekuestruar në kuadër të hetimit, të ekzaminohet nga agjenci partnere jashtë Shqipërisë.

Ish-kreu i SHISH, ka pretenduar gjithashtu se gjatë kohës që ka drejtuar SHISH nuk ka dalë prej saj asnjë dokument i klasifikuar.

Në seancë janë paraqitur edhe dy personat e tjerë të dyshuar në këtë çështje.

mbro Sulejmani, i punësuar si kamarier në një subjekt privat, ka mohuar përfshirjen në ndonjë krim, duke deklaruar se e njihje Ergys Agasin, pasi të dy janë nga Durrësi, dhe se e kishte ndihmuar me ushqim.


Ndërkohë, përgjegjësi i Policisë Shkencore, Fation Kalloshi, sipas Hoxhës, ka deklaruar se nuk mban mend të ketë dërguar informacione në telefonin e Agasit.

Seanca është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe SPAK ka rikujtuar ndalimin e shpërndarjes së të dhënave të administruara gjatë saj.

Pas përfundimit të seancës, gazetarët qëndruan jashtë ambienteve të SPAK dhe i drejtuan pyetje Hysenit lidhur me hetimin. Sipas Hoxhës, ish-drejtorja e SHISH nuk ka dhënë përgjigje dhe është larguar në heshtje nga ambientet e Prokurorisë së Posaçme./Versus.al

28 MINUTA ME PARE

Akt-ekspertimi i “Land Rover”-it të Ergys Agasit përfundon në “Signal”. SPAK heton rrjedhjen e materialeve nga Policia Shkencore



Një akt-ekspertimi i kryer nga Policia Shkencore me kërkesë të SPAK për një automjet tip “Land Rover Defender” të sekuestruar në kuadër të hetimeve, dyshohet se ka përfunduar në aplikacionin “Signal” të Ergys Agasit gjatë muajit gusht 2026.

Automjeti luksoz, me ngjyrë të zezë, u sekuestrua më 22 korrik 2026 nga BKH-ja në garazhin e vilës së Agasit, pranë kompleksit “Equos Resort”.

Sipas të dhënave të hetimit, automjeti ishte urdhëruar t’i nënshtrohej ekspertimit daktiloskopik për evidentimin e gjurmëve të gishtave, fijeve të flokëve dhe materialeve të tjera, si dhe për krahasimin e tij me pamjet e një “Land Rover Defender” që dyshohet se është përdorur në rëmbimin e biznesmenit Gerond Meçe.

Pas kryerjes së veprimeve dhe përfundimit të ekspertizës, Policia Shkencore përgatiti aktin përfundimtar dhe ia përcolli Prokurorisë së Posaçme, në përgjigje të kërkesës për ekspertimin e automjetit.

Por, sipas hetimit të SPAK, disa ditë më vonë, gjatë gushtit, tre faqe të këtij akt-ekspertimi dyshohet se janë dërguar përmes aplikacionit “Signal” në numrin e Ergys Agasit./Versus.al

4 ORE ME PARE

Arrestimi i ish-kreut të SHISH, mblidhet javën e ardhshme Këshilli i Sigurisë Kombëtare



Javën e ardhshme pritet të mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare, për të diskutuar mbi çështjen e arrestimit të ish-shefes së SHISH, Vlera Hyseni.

Megjithatë nuk është përcaktuar një datë apo orë pasi duket se mungesa e kryeministrit Edi Rama është një nga arsyet.

Mësohet se Rama pritet të kthehet në Shqipëri më 26 shtator.

Lëvizja e kreut të shtetit vjen në një kohë kur çështja e ish-drejtoreshës së SHISH, Vlera Hyseni, ka nxitur debate mbi sigurinë kombëtare dhe kërkesa nga opozita për mbledhjen e këtij këshilli.

Ish-shefja e SHISH Vlera Hyseni u shkarkua nga detyra nga kryeministri Edi Rama, pasi ndaj saj GJKKO ka caktuar masën e sigurisë "arrest shtëpie". Kujtojmë që Hyseni dyshohet për dy vepra penale, "nxjerrjen e sekretit shtetëror" dhe "përkrahje e autorëve të krimit." [Versus.al](#)

5 ORE ME PARE

GJKKO reagon zyrtarisht pas vendimit për ish-shefen e SHISH Vlera Hyseni. Ndalon publikimin deri në fund të hetimeve paraprake



Gjykata e Posaçme ka lënë në fuqi masën e sigurisë "Arrest në shtëpi" për ish-drejtoreshën e SHISH, Vlera Hyseni.

Vendimi është marrë këtë të enjte, më 24 shtator, pas kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për marrjen në pyetje të Hysenit, e cila është person nën hetim.

Sipas njoftimit zyrtar të GJKKO-së, me vendimin nr. 69, datë 24.09.2026, gjyqtarja Flojera Davidhi vendosi vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrest në shtëpi", të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka vendosur gjithashtu ndalimin e publikimit, tërësisht ose pjesërisht, të vendimit gjyqësor deri në përfundim të hetimeve paraprake, në bazë të nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore u zhvillua me dyer të mbyllura dhe zgjati rreth dy orë e 20 minuta. Pas daljes nga GJKKO, Vlora Hyseni nuk iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve lidhur me përgjimet e SPAK.

Në njoftimin e saj, GJKKO bën me dije se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme është paraqitur më 23 shtator 2026 dhe lidhet me marrjen në pyetje të Vlorës Hyseni, ndaj së cilës ishte caktuar më herët masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”.

Hetimet për çështjen vijojnë, ndërsa gjykata ka kufizuar publikimin e vendimit deri në përfundimin e fazës së hetimeve paraprake.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.